



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Media Center "Vala" Sh.p.k.
Pronar – Shpejtim NDRECAJ
Radio Vala 2000
Rr/ Brigada 123, p.n.
Therandë

Ref:1609/980/KPM/am

VENDIM

për ripërtëritjen e licencës së transmetimit dhe ndryshimin e pronësis të Radio Vala 2000, me seli në Therandë

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuele, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës si dhe standardet ndërkombëtare.
2. Radio Vala 2000 është subjekt transmetues me mbulueshmëri lokale i cili është licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për transmetimin e radio programeve në komunën e Therandës , me seli në Therandë, regjioni i Prizrenit. KPM, me datën 28 gusht 2009, ka marr vendim për dhënien e licencës afatgjatë për Radio Vala 2000.
3. Me datën 28 gusht 2016, afati i licencës së Radio Vala 2000 ka skaduar, ndërsa, në bazë të nenit 25 të Ligjit për KPM-në, kandidati ka të drejtë të kërkojë përtëritjen e licencës nga KPM brenda gjashtë (6) muajve para skadimit të datës së licencës ekzistuese dhe minimum gjashtëdhjetë (60) ditë para skadimit të licencës.
4. Më 11 gusht 2016, Departamenti i Licencimit, pranë Zyrës Ekzekutive të KPM-së, e ka njoftuar të licencuarin lidhur me obligimet që parashihen me nenin 25, duke e udhëzuar kandidatin që të bëjë kërkesën për vazhdim të licencës, brenda afateve të përcaktuara me këtë nen, si dhe të kryej të gjitha obligimet ndaj tarifës vjetore për licencë të KPM-së.

1/3

5. Radio Vala 2000 me datën 16 maj 2016, ka parashtruar kërkesën me shkrim në KPM, për të shprehur interesimin e tij për ripërtëritje të licencës.
6. Radio Vala 2000 nuk ka obligime ndaj tarifës vjetore për licencë të KPM-së.
7. Me datën 23 gusht 2016, pronari i Radio Vala 2000 z. Bashkim NDRECAJ ka dorzuar në zyrën e KPM-së edhe kërkesën për ndryshimin e pronësis duke e kaluar atë nga N.SH.E. "Matiqeva-Comerc" (biznes i cili është shuar me vdekjen e njërit prej pronarëve) dhe kalimin te Media Center "Vala" Sh.p.k., me pronarë z. Shpejtim NDRECAJ.
8. Me anë të një deklaratë, si pjesë e kërkesë për ndryshimin e pronësis, kandidati për pronarë të vetëm të Radio Vala 2000 ka theksuar se përveq ndryshimeve në pronësi, nuk do të ketë ndryshime tjera si: skema programore, ndryshime të stafit apo ndryshime të kriterëve teknike të licencës.

Arsyetimi

9. Radio Vala 2000 ka vepruar pajtim me nenin 25 të Ligjit të KPM-së, duke parashtruar kërkesën për ripërtëritje të licencës së KPM-së, e gjithashtu, ka kryer obligimet ndaj tarifës për licencë.
10. Vendimi i KPM-së (**KPM V2-2016**), i datës 8 shtator 2016, krijon bazën ligjore që të ripërtërijë licencën e kandidati të cilët kanë parashtruar kërkesën për ripërtëritje.
11. Duke marrë parasysh se Radio Vala 2000, ka vepruar në pajtim me udhëzimet e KPM-për të vepruar në pajtim me nenin 25 dhe nenin 26 të Ligjit për KPM-në, KPM konstaton se ka bazë të mjaftueshme për ripërtëritje të licencës së transmetimit për Radio Vala 2000.
12. Arsyeja për ndryshimin e pronësisë së Radio Vala 2000 është shuarja e biznesit N.SH.E. "Matiqeva-Comerc", në emër të cilit është lëshuar licenca e KPM-së për Radio Vala 2000, me vdekjen e njërit prej bashkëpronarve si dhe inkuadrimi i z. Bashkim Ndrecaj, si pronarë i deritanishëm i radios, në struktura udhëheqëse të një subjekti politik.
13. Duke marrë për bazë shuarjen e biznesit si bartës i licencës së Radio Vala 2000 dhe inkuadrimin e pronarit të deritanishëm në struktura udhëheqëse të një subjekti politik si dhe gatishmërinë e kandidatit për pronarë të vetëm, për të vepruar në pajtueshmëri me të gjitha rregulloret dhe udhëzimet e KPM-së, KPM, konsideron se ka bazë të mjaftueshme për ndryshimin e pronësisë së Radio Vala 2000 dhe bartjen e saj tek personi juridik Media Center "Vala" Sh.p.k.

VENDIM

14. KPM merr vendim për ripërtëritjen e licencës së Radio Vala 2000, për të ushtruar veprimtari në ofrimin e shërbimeve mediale audio, me interes publik në zonën ku operon.

15. KPM merr vendim për ndryshimin e pronësisë së Radio Vala 2000, duke e kaluar atë nga N.S.H.E. "Matiqeva-Comerc" tek Media Center "Vala" Sh.p.k, me pronar z. Shpejtim NDRECAJ.
16. Licenca e transmetimit të KPM-së për Radio Vala 2000 do të jetë e vlefshme në afat prej 7 (shtatë) viteve, bazuar në Nenin 21, paragrafin 2 të Ligjit për KPM-në, ndërsa, vlefshmëria e licencës do të llogaritet nga data 28 gusht 2016.
17. Të gjitha parametrat e licencës së KPM-së, si: Kategoria e të Licencuarit, Skema Programore, Parametrat Teknik si dhe Harta e Zonës së Mbulimit, mbesin të pandryshuara nga licenca paraprake.
18. Këtë vendim e lëshon Komisioni i Pavarur i Mediave.



Adnan MEROVCI

Kryetar

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE



12.10.2016

datë